



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 56

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E premte, 20 prill 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 16/2018 datë 5.4.2018	Për diasporën..... 3291
Rezolutë e Kuvendit datë 12.4.2018	Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2017..... 3297
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 11, datë 17.4.2018	Për rregullat e brendshme mbi mënyrën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë..... 3299
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 300, datë 11.4.2018	Për miratimin e formularit dhe kërkesat e raportit mbi sigurinë e produktit kozmetik..... 3305
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 22, datë 30.3.2018	Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Rrogozhinë..... 3308
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 23, datë 30.3.2018	Për disa ndryshime në vendimin nr. 10, datë 21.3.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Vlorë” 3309
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 24, datë 30.3.2018	Për një ndryshim në vendimin nr. 41, datë 6.10.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjellës Gramsh” 3309

Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 25, datë 30.3.2018	Për mosmarrjen në shqyrtim të aplikimit për miratimin e tarifave të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër.....	3310
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 26, datë 30.3.2018	Mbi mosmarrjen në shqyrtim të aplikimit për miratimin e tarifave të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Krujë.....	3311



LIGJ
Nr. 16/2018

PËR DIASPORËN

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj ka për objekt përcaktimin e rregullave për:

- a) kompetencat e autoriteteve shtetërore përgjegjëse për marrëdhëniet me diasporën;
- b) mënyrën e mbajtjes, të forcimit dhe realizimit të lidhjeve të diasporës me vendin e origjinës;
- c) krijimin e Këshillit Koordinues të Diasporës;
- ç) dhënien e çmimeve kombëtare në fushën e marrëdhënieve ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës;
- d) ruajtjen dhe kultivimin e identitetit kombëtar, gjuhësor, kulturor e arsimor të pjesëtarëve të diasporës dhe lidhshmërinë e tyre me institucionet shtetërore në vendin e origjinës.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Agjencia Kombëtare e Diasporës”, në vijim “Agjencia”, është organi shtetëror përgjegjës për marrëdhëniet me diasporën.
2. “Diaspora” përfshin:
 - a) komunitetet e hershme shqiptare në botë;
 - b) çdo person, i cili është lindur në Shqipëri dhe jeton jashtë kufijve të saj;
 - c) çdo person që gëzon origjinë shqiptare, i cili ka lindur jashtë kufijve të Shqipërisë, mban lidhje gjuhësore, kulturore e të traditës në vazhdimësi dhe që ka dëshirë të ruajë lidhjet me Shqipërinë.
3. “Ministër përgjegjës” është ministri që mbulon fushën e veprimtarisë shtetërore për marrëdhëniet me diasporën.

4. “Vend i origjinës” është Republika e Shqipërisë.

5. “QKD” është qendër kulturore për diasporën, themeluar në vendet me interes për diasporën dhe Republikën e Shqipërisë.

6. “Këshilli Koordinues i Diasporës” (Këshilli) është organi përfaqësues dhe koordinues i marrëdhënieve me diasporën.

7. “Organizata e diasporës” është organizim vullnetar i pjesëtarëve të diasporës.

KREU II

ORGANET SHTETËRORE PËRGJEGJËSE
PËR MARRËDHËNIET
ME DIASPORËN

Neni 3

Organet shtetërore përgjegjëse për diasporën

Organet shtetërore përgjegjëse për marrëdhëniet me diasporën janë:

1. Këshilli i Ministrave.
2. Komiteti Shtetëror për Diasporën.
3. Ministri përgjegjës për diasporën.
4. Këshilli Koordinativ për Diasporën.
5. Agjencia Kombëtare e Diasporës.
6. Qendrat kulturore për diasporën.
7. Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.
8. Qendra e Botimeve për Diasporën.
9. Autoritete të tjera shtetërore, në përputhje me fushën e tyre të veprimtarisë.

Neni 4

Këshilli i Ministrave

Këshilli i Ministrave përcakton:

- a) politikat e vendit të origjinës për diasporën, për t’u zbatuar nga organet shtetërore përgjegjëse për marrëdhëniet me diasporën;
- b) mënyrën dhe politikat për regjistrimin e shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 5

Ministri përgjegjës për diasporën

Ministri përgjegjës për diasporën ushtron këto kompetenca:

- a) i propozon Këshillit të Ministrave nxjerrjen e akteve rregulluese dhe marrjen e masave të tjera të nevojshme për realizimin e politikës shtetërore për marrëdhëniet me diasporën;



b) mbikëqyr dhe koordinon zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Marrëdhëniet me Diasporën;

c) mban dhe monitoron marrëdhëniet me diasporën;

ç) krijon dhe përditëson në mënyrë sistematike të dhëna për organizimin e saj në forume;

d) bashkëpunon me ministritë përgjegjëse, sipas fushave të veprimtarisë, për themelimin e qendrave kulturore dhe informative në vendet ku jeton diaspora;

dh) i propozon Kryeministrit dhënien e çmimeve për kontribute të veçanta në ruajtjen e forcimin e lidhjeve ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës, si dhe për kontribute të veçanta në promovimin e Shqipërisë në botë;

e) krijon marrëdhënie dhe promovon aktivitete përafruese e lidhëse me ambasadat përkatëse në shtete ku jeton diaspora;

ë) ushtron kompetenca të tjera, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 6

Qendrat kulturore për diasporën

1. QKD-të krijohen me qëllim ruajtjen, kultivimin e identitetit kombëtar, gjuhësor, kulturor e arsimor të diasporës dhe forcimin e lidhjeve të saj me institucionet e Republikës së Shqipërisë.

2. QKD-të ushtrojnë veprimtarinë në vendet me interes për diasporën e Republikës së Shqipërisë dhe hapen në marrëveshje me këto vende.

3. Kreu i QKD-së emërohet dhe lirohet me urdhër të ministrit përgjegjës për punët e jashtme, me propozim të ministrit përgjegjës për diasporën. Kreu i QKD-së gëzon status diplomatik, për periudhën e ushtrimit të detyrës dhe pajiset me pasaportë diplomatike.

4. QKD-ja është në varësi të kreut të misionit diplomatik të akredituar në atë vend dhe ushtron funksionet në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga ky ligj dhe detyrime të tjera që burojnë nga legjislacioni në fuqi.

5. Marrëdhëniet e punës për punonjësit e QKD-së rregullohen sipas dispozitave në fuqi të Kodit të Punës. Rregullat e hollësishme për rekrutimin e punonjësve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për diasporën dhe ministrit përgjegjës për punët e jashtme.

6. Krijimi, organizimi, mënyra e funksionimit dhe nivelet e pagave të QKD-së miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

7. Struktura dhe organika e QKD-së miratohen me urdhër të Kryeministrit.

8. Agjencia Kombëtare e Diasporës bashkëpunon dhe koordinon veprimtaritë me QKD-të.

Neni 7

Përgjegjësitë e QKD-së

1. QKD-ja ka përgjegjësi:

a) të promovojë Shqipërinë;

b) të nxitë dhe të zhvillojë njohuri për gjuhën, kulturën dhe trashëgiminë kulturore të Shqipërisë;

c) të nxitë bashkëpunimin shkencor, teknik, teknologjik, sportiv e ekonomik ndërmjet Shqipërisë dhe diasporës;

ç) të ofrojë informacione për investimet në Shqipëri, lehtësitë fiskale, organizimet kulturore e arsimore, takime me bashkatdhetarët dhe me institucione shtetërore në Shqipëri;

d) të mbështetë dhe të organizojë veprimtaritë kulturore, edukative e sportive;

dh) të kryejë detyra të tjera, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

2. Kreu i QKD-së merr udhëzime nga ministri përgjegjës për diasporën, nëpërmjet kreut të misionit diplomatik të vendit ku është akredituar dhe i informon ata në mënyrë të rregullt për aktivitetin e tij.

Neni 8

Financimi i QKD-së

Mjetet për veprimtari të QKD-së sigurohen nga:

a) buxheti i shtetit;

b) të ardhura nga projekte, donacione dhe burime të tjera të ligjshme.

KREU III

MBAJTJA, FORCIMI DHE REALIZIMI I LIDHJEVE NDËRMJET VENDIT TË ORIGJINËS DHE DIASPORËS

Neni 9

Lidhjet ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës

Mbajtja, forcimi dhe realizimi i marrëdhënieve ndërmjet vendit të origjinës e diasporës realizohen nëpërmjet:



a) përmirësimit të pozitës së pjesëtarëve të diasporës dhe mbrojtjes së të drejtave e interesave të tyre nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare dy a shumëpalëshe, në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare;

b) përdorimit e mësimi të gjuhës shqipe, si dhe ruajtjes së identitetit kulturor, etnik, gjuhësor;

c) promovimit të bashkëpunimit ekonomik, lehtësimit fiskal ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës;

ç) sigurimit të kushteve për funksionimin e Këshillit Koordinues të Diasporës;

d) dhënies së çmimeve kombëtare për kontribut të veçantë në ruajtjen, forcimin e lidhjeve ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës, promovimin e Shqipërisë në botë dhe përkrahjen e interesave të saj.

Neni 10

Përkrahja për mësimin dhe avancimin e gjuhës shqipe

1. Këshilli i Ministrave, nëpërmjet ministrit përgjegjës, ndihmon në krijimin e kushteve për ruajtjen dhe mësimin e gjuhës shqipe.

2. Ministri përgjegjës, së bashku me ministrinë përgjegjëse për arsimin, sipas programit arsimor, ndihmon dhe përkrah zhvillimin e procesit mësimor të gjuhës shqipe në vendet ku ka një numër të madh pjesëtarësh të diasporës, shtrirje më kompakte apo interes të veçantë shtetëror.

3. Ministri përgjegjës për diasporën dhe ministri përgjegjës për arsimin nënshkruajnë marrëveshje dypalëshe me institucionet shtetërore homologe të vendeve ku jetojnë pjesëtarë të diasporës për organizimin e procesit mësimor të gjuhës shqipe dhe njohurive të tjera kulturore për Republikën e Shqipërisë.

4. Organizimi i procesit mësimor dhe përzgjedhja e arsimtarëve në vendet përkatëse, ku jeton dhe vepron diaspora, rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për diasporën dhe ministrit përgjegjës për arsimin, duke respektuar marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara në fuqi.

5. Ministri përgjegjës për diasporën, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për arsimin, ndihmon në shpërndarjen e librave të përshtatur për mësimin dhe avancimin e gjuhës shqipe e të njohurive të tjera kulturore për

Republikën e Shqipërisë në vendet ku jeton dhe vepron diaspora.

6. Ministri përgjegjës për diasporën, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për arsimin, përgatit dhe zbaton programe për mësimin e gjuhës shqipe në distancë, nëpërmjet internetit (programe telefoni ose tabletë) dhe rrjeteve e kanaleve elektronike të komunikimit masiv, mësimin e historisë së Shqipërisë dhe njohurive të tjera kulturore për të, organizon seminare trajnuese për mësuesit, promovon dhe merr masa të ndryshme për inkurajimin e mësimi plotësues për pjesëtarët e diasporës.

Neni 11

Bashkëpunimi kulturor dhe promovimi i trashëgimisë kulturore të Shqipërisë

1. Ministri përgjegjës për diasporën, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për kulturën, përkrah aktivitetet kulturore të pjesëtarëve të diasporës, me synim ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit, ruajtjen e trashëgimisë kulturore, si dhe promovimin e shtrirjes së tyre.

2. Në Muzeun Historik Kombëtar themelohet një pavion i veçantë për diasporën.

3. Ministri përgjegjës për diasporën, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për kulturën, mbështet komunitetet shqiptare në shtetet e ndryshme ku ata jetojnë dhe ndihmojnë, nxisin e zhvillojnë marrëdhënie ndërkulturore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shteteve përkatëse, sipas këtij ligji dhe akteve të tjera nënligjore.

4. Ministri përgjegjës për diasporën, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për kulturën, ndihmon të rinjtë në promovimin, ruajtjen, kultivimin e identitetit kulturor, gjuhësor dhe të trashëgimisë kulturore në interes të kujtesës historike për vendin e origjinës, nëpërmjet thirrjeve publike të posaçme për bashkëpunime konkrete dhe nxjerrjen e kalendarëve të eventeve të mundshme të bashkëpunimit ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës.

Neni 12

Bashkëpunimi në fushën e sportit

Ministri përgjegjës për diasporën, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për sportin, përkrah aktivitetet sportive të pjesëtarëve të diasporës, me synim ruajtjen dhe zhvillimin e



identitetit, të trashëgimisë kulturore, si dhe promovimin e shtrirjes së tyre.

Neni 13 Informimi

1. Radiotelevizioni Shqiptar siguron një kanal transmetimi me program radioteleviziv për diasporën. Shpenzimet për prodhimin e programeve të dedikuara për diasporën dhe transmetimin përballohen nga buxheti i shtetit.

2. Biblioteka Kombëtare, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe kulturën, mundëson aksesin në fondin e librave *online*, pa pagesë, për edukimin dhe letërsinë, dedikuar interesave të diasporës.

3. Këshilli i Ministrave nxit dhe inkurajon aktivitetet mediatike të pjesëtarëve të diasporës së Shqipërisë, bazuar në efikasitetin e veprimtarisë së tyre.

Neni 14 Ekonomia dhe shkenca

1. Ministri përgjegjës për diasporën i kushton vëmendje të veçantë fuqizimit të lidhjeve ekonomike, bashkëpunimit në fushën e shkencës e të zhvillimit të teknologjive të reja ndërmjet diasporës dhe institucioneve të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet bashkëpunimit ekonomik dhe masave të ndryshme të politikës ekonomike, sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

2. Ministri përgjegjës për diasporën, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse shtetërore, përkrah bashkëpunimin me figurat e shquara të shkencës, pjesëtarë të diasporës, në projektet kërkimore institucionale.

Neni 15 Çmimi vjetor i diasporës

1. Për pjesëtarët e suksesshëm të diasporës akordohet çmimi “Ambasador i kombit”.

2. Kriteret dhe mënyra e ndarjes së çmimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 16 Burimet financiare

Fondet për ruajtjen dhe forcimin e lidhjeve të vendit të origjinës e diasporës sigurohen nga:

a) buxheti i shtetit;

b) të ardhura nga projekte, donacione dhe burime të tjera të ligjshme.

KREU IV ORGANIZIMI I DIASPORËS

Neni 17 Organizata e diasporës

1. Organizata e diasporës është një organizim vullnetar, jofitimprurës i diasporës, që vepron në përputhje me rregullat e vendit të huaj ku jeton diaspora.

2. Organizata e diasporës ka si qëllim promovimin e Shqipërisë dhe përkrahjen e interesave shtetërore të saj, ruajtjen e nxitjen e marrëdhënieve kulturore, arsimore, shkencore, humanitare dhe sportive me vendin e origjinës.

Neni 18 Këshilli Koordinues i Diasporës

1. Këshilli Koordinues i Diasporës (Këshilli) përfaqëson dhe koordinon marrëdhëniet me diasporën.

2. Këshilli ka këto kompetenca:

a) identifikon problemet e diasporës, i propozon ministrit përgjegjës për diasporën veprime për zgjidhjen e tyre, përcakton linja orientuese për hartimin e strategjisë për diasporën;

b) miraton rregulla procedurale për përmbushjen e veprimtarisë së tij dhe procedurën e vendimmarrjes.

3. Përgjegjësitë profesionale, të përdorimit të fondeve dhe ato administrative, për Këshillin do të ushtrohen nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.

4. Agjencia Kombëtare e Diasporës kryen funksionet e sekretariatit teknik.

Neni 19 Përbërja e Këshillit

1. Këshilli përbëhet nga 15 anëtarë, të cilët janë përfaqësues të diasporës.

2. Në aktivitetet e Këshillit marrin pjesë Kryeministri, ministrat përgjegjës për diasporën, punët e jashtme, punët e brendshme, për financat dhe ekonominë, arsimin, kulturën, Akademia e Shkencave, Dhoma Kombëtare e Tregtisë dhe Industrisë, Radiotelevizioni Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Diasporës, si dhe përfaqësues të qendrave kulturore të diasporës.



3. Presidenti i Republikës, me kërkesën e tij dhe në koordinim me Kryeministrin dhe ministrin e shtetit përgjegjës për diasporën, merr drejtimin e mbledhjeve të veçanta të Këshillit Koordinues të Diasporës.

Neni 20

Kriteret për zgjedhjen në Këshill

1. Përfaqësuesit e diasporës, të cilët do të jenë anëtarë në Këshill, duhet të përmbushin këto cilësi:

a) të kenë integritet të lartë dhe reputacion në komunitetin ku ata jetojnë;

b) të kenë aftësi për të përmbushur detyrat për mbajtjen dhe forcimin e marrëdhënieve ndërmjet vendit të origjinës e diasporës.

2. Përfaqësuesit e diasporës zgjidhen sipas këtij rendi:

a) tre përfaqësues nga diaspora e Shteteve të Bashkuara të Amerikës;

b) dy përfaqësues nga diaspora e Kanadasë;

c) gjashtë përfaqësues nga diaspora e Evropës;

ç) një përfaqësues nga diaspora e Turqisë;

d) një përfaqësues nga diaspora e Australisë;

dh) dy përfaqësues nga Britania e Madhe.

3. Rregullat e hollësishme për kushtet dhe mënyrën e zgjedhjes së përfaqësuesve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Vendi i origjinës nuk ushtron influencë në procedurat dhe kushtet e zgjedhjes së përfaqësuesve në Këshill.

5. Vendimi për zgjedhjen e përfaqësuesve i njoftohet ministrit përgjegjës për diasporën të paktën 30 ditë përpara datës së përcaktuar për mbledhjen e Këshillit.

Neni 21

Mbledhja e Këshillit

1. Këshilli mbledhet, si rregull, Ditën Kombëtare të Diasporës.

2. Këshilli mund të mbledhet në sesion të jashtëzakonshëm, me kërkesën e, të paktën, 1/3 së të përfaqësuarve ose me kërkesë të ministrit përgjegjës për diasporën, me një program të përcaktuar paraprakisht.

3. Këshilli, sipas nevojës, mund të krijojë grupe pune për të trajtuar çështje teknike, me natyrë ekonomike, statutore, kulturore, shkencore e sportive. Numri i anëtarëve dhe mënyra e

organizmit e funksionimit të grupeve të punës përcaktohet me vendim të Këshillit Koordinues të Diasporës.

Neni 22

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës

1. Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka për mision sigurimin dhe shpërndarjen e mjeteve financiare, në kuadrin e nxitjes së zhvillimit social-ekonomik e kulturor, bazuar në strategjitë e caktuara prioritare për diasporën, si edhe brenda vendit, nëpërmjet promovimit, inkurajimit dhe orientimit të prirjeve filantropike dhe investimeve të diasporës në mbështetje të zhvillimit në Republikën e Shqipërisë e jashtë saj.

2. Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës shërben si mekanizëm i njohur nga ligji për orientimin e prirjeve filantropike/donacioneve dhe investimeve të anëtarëve të diasporës në përpjekjet për zhvillimin social-ekonomik e kulturor në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj.

3. Rregullat për veprimtarinë, organizimin dhe funksionimin e Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës miratohen me ligj të veçantë.

KREU V

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 23

Qendra e Botimeve për Diasporën

1. Botimi i teksteve të veçanta, të cilat i shërbejnë diasporës, realizohet nëpërmjet Qendrës së Botimeve për Diasporën që financohet nga buxheti i shtetit dhe organizohet e funksionon në varësi të ministrit përgjegjës për diasporën.

2. Krijimi, organizimi dhe funksionimi i Qendrës së Botimeve për Diasporën rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 24

Marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë

Për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji, në përbërje të Komisionit të Përhershëm për Politikën e Jashtme të Kuvendit të Shqipërisë, krijohet një nënkomision “Për diasporën dhe migracionin”, i cili organizohet dhe funksionon sipas parashikimeve ligjore për nënkomisionet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 25
Dita e diasporës

Data 18 dhjetor caktohet si Dita Kombëtare e Diasporës.

Neni 26

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, Këshilli Koordinues për Diasporën, Qendrat Kulturore për Diasporën dhe Qendra e Botimeve për Diasporën kanë logot e tyre. Modeli i logove është sipas formatit të anekseve bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 27
Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të neneve 4; 6, pikat 5 e 6; 10, pika 4; 15, pika 2; 20, pika 3; dhe 23, pika 2, të këtij ligji.

Neni 28
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 5.4.2018

Shpallur me dekretin nr. 10765, datë 18.4.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta





REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2017

Pas shqyrtimit të raportit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mbi veprimtarinë e vitit 2017 dhe duke shqyrtuar referimin e raportit vjetor të KQZ-së dhe raportin e OSBE-ODHIR-it;

- Organizimin e zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvendin dhe të zgjedhjeve për kryetar bashkie në Kavajë;

- Problematikat e përsëritura gjatë mbikëqyrjes së listave të zgjedhësve, që kanë të bëjnë me zgjedhës të dyshuar si të dubluar apo të atyre pa kod vendbanimi;

- Çështjet e trajtuara nga raporti i OSBE-ODHIR-it për vlerësimin e procesit nga këndvështrimi i shqyrtimit të akteve dhe veprimeve të KQZ-së;

- Trajtimin nga KQZ-ja të rasteve të lidhura me zbatimin e ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin

e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

- Vendimmarrjen e KQZ-së të datës 12.12.2017 në lidhje me rezultatin e verifikimit të financimit të fushatave zgjedhore të subjekteve zgjedhore,

Kuvendi i Shqipërisë konstaton se KQZ-ja gjatë vitit 2017:

- Ka plotësuar përgjithësisht kërkesat dhe detyrat e lëna nga Kuvendi, me rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit për vitin 2016 e që përfshiheshin në fushën e veprimtarisë dhe kompetencën e KQZ-së.

- Ka monitoruar problematikat e procesit zgjedhor gjatë zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvendin dhe të zgjedhjeve për kryetar bashkie në Kavajë.

- Ka realizuar vendimmarrjen e KQZ-së në funksion të procesit zgjedhor.

- Ka trajtuar pjesërisht çështje në kuadër të dispozitave të Kodit Zgjedhor për financimin e fushatave zgjedhore, si dhe zbatimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të



personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Në këto kushte, duke konsideruar edhe faktin që viti në vazhdim nuk është vit zgjedhor,

Kuvendi i Shqipërisë i kërkon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve fokusimin në këto drejtime:

- Të bëhet analizë e të gjithë vendimmarrjes së KQZ-së gjatë procesit zgjedhor të vitit 2017, duke mbajtur në konsideratë gjetjet e raportit të OSBE-ODHIR-it. Gjatë procesit të verifikimit të vendimmarrjes, t'u kushtohet rëndësi e posaçme trajtimit, rregullimit ose plotësimit me akte që janë kompetencë e KQZ-së, të çështjeve të shitblerjes së votës, korrupsionit të administratës zgjedhore, mashtrimit zgjedhor, abuzimit me burimet shtetërore dhe presioneve mbi zgjedhësit, si dhe ato të lidhura me vendin e punës. Në funksion të përmirësimit të gjendjes së evidentuar nga raporti i OSBE-ODHIR-it edhe gjatë këtij viti të vijojnë trajnimet.

- Të miratojë program pune të posaçëm për vitin në vazhdim. Programi të konsiderojë që viti në vazhdim nuk është vit zgjedhor dhe në këto kushte ai duhet t'i shërbejë institucionit dhe administratës për organizimin dhe plotësimin e veprimtarive që janë të pamundura në një vit zgjedhor.

- Të hartojë metodologjitë e kontrollit dhe verifikimit të shpenzimeve të financimeve të partive politike dhe fushatave elektorale, brenda dhe jashtë vendit, duke shqyrtuar edhe mundësinë e lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit me autoritetet përgjegjëse që kontrollojnë pastrimin e parave dhe financimet e kundërligjshme. Nëse për procesin e kontrollit dhe të verifikimit të financimeve të partive politike, KQZ-ja ka nevojë për mbështetje nga Kuvendi, të formulojë dhe të paraqesë në Kuvend sa më shpejt kërkesa konkrete, të qarta, të detajuara dhe të mirargumentuara, duke konsideruar përdorimin e burimeve të veta njerëzore gjatë një viti jozgjedhor. Të thellojë dhe të përmirësojë shqyrtimin administrativ të verifikimit të financimeve të fushatave zgjedhore mbi bazën e dokumenteve dhe fakteve të deklaruar apo të bëra publike.

- Të vijojë menjëherë procedurat e ndërprera të mbledhjes së detyrimeve financiare që u kanë lindur subjekteve zgjedhore për shkak të

vendimeve të dënimeve me gjobë për shkelje të dispozitave ligjore. Për të lehtësuar punën e KQZ-së, Kodi, në nenin 176, i ka trajtuar vendimet e KQZ-së për ndëshkimet administrative me gjobë si tituj ekzekutivë, për ekzekutimin e të cilave zbatohen dispozitat e Kodit Civil.

- Të marrë në shqyrtim databazën me të dhënat për administratën zgjedhore dhe të përpunojë konkluzionet që dalin nga të dhënat, duke e trajtuar çështjen nga këndvështrimi historik i sjelljes politike të subjekteve zgjedhore gjatë proceseve zgjedhore;

- Të synojë në një sjellje institucionale për sa i takon vendimmarrjes, në funksion të ruajtjes së pavarësisë dhe referim në dispozitat ligjore dhe jo duke arsyetuar mbi diskrecionin. Në plotësim të kësaj kërkesë, të analizojë të gjitha vendimet e marra në kuadër të respektimit të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe të sigurojë në të ardhmen interpretimin dhe zbatimin me paanësi dhe të njëjtë të ligjit.

- Të vazhdojë bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe të insistojë pranë autoriteteve shtetërore për përmirësimin e regjistrave përkatës, si dhe sistemit të adresave.

- Të marrë masa që në vijim raportet vjetore të institucionit të ofrojnë edhe analizë profesionale të proceseve dhe problematikave të hasura gjatë vitit, duke mos u mjaftuar me një referim kronologjik të dokumenteve, veprimeve dhe vendimeve të KQZ-së apo të subjekteve zgjedhore, gjatë ose jashtë proceseve zgjedhore.

Miraturar në datën 12.4.2018

**UDHËZIM****Nr. 11, datë 17.4.2018****PËR RREGULLAT E BRENDSHME MBI
MËNYRËN E EKZEKUTIMIT TË
VENDIMEVE GJYQËSORE TË
MINISTRISË SË FINANCIVE
DHE EKONOMISË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës; të neneve 510, 589, të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të neneve 43 e 54, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2012, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 152, datë 30.5.2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZON:**KREU I
TË PËRGJITHSHME**

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i mënyrës së ekzekutimit të detyrimeve monetare, që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë, për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

2. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore, realizohet nga struktura përgjegjëse për financat:

a) Me fondet buxhetore, të akorduara në ligjin vjetor të buxhetit përkatës, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore;

b) Nga të ardhura të tjera, të siguruara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bazë të legjislacionit përkatës dhe, të cilat shërbejnë si burime financimi për vetë njësinë (nëse ka).

3. Struktura përgjegjëse për financat, çdo vit, parashikon fonde buxhetore të planifikuara për shpenzimet që do të kryejë institucioni, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

4. Struktura përgjegjëse për financat është përgjegjëse për dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare. Ajo përgjigjet, gjithashtu, për garantimin para miratimit të shkresave/urdhrave me karakter financiar, lidhur me ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe respektimin e parimeve të ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit.

5. Struktura përgjegjëse për financat, me përparësi në vitet e ardhshme, planifikon fondet e nevojshme për shlyerjen e këtyre detyrimeve të mbartura, duke ndjekur procedurat përkatëse të planifikimit të fondeve buxhetore, të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore përkatëse.

6. Në shlyerjen e vendimeve gjyqësore nga ana e strukturës përgjegjëse për financat, duhet t'i jepet përparësi shlyerjes së detyrimeve më të hershme.

7. Nëpunësi autorizues raporton te Titullari i institucionit, në mënyrë periodike, në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

KREU II**PROCEDURAT E NDJEKJES SË ÇËSHTJEVE
GJYQËSORE DHE EKZEKUTIMI I
VENDIMEVE GJYQËSORE**

1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë merr zyrtarisht njoftimin për çështjen gjyqësore me datën e seancës ose kërkesëpadinë e komunikuar nga Gjykata, me qëllim lënien e afatit për përgatitjen e argumenteve mbrojtëse. Njoftimi, pasi protokollohet në institucion, i kalon Sekretarit të Përgjithshëm. Sekretari i Përgjithshëm bën delegimin e praktikës për trajtim, pranë strukturës përgjegjëse për ndjekjen e proceseve gjyqësore.

2. Drejtuesi i strukturës përgjegjëse për ndjekjen e proceseve gjyqësore, pasi merr nga Sekretari i Përgjithshëm në dorëzim praktikën, cakton një përfaqësues për të ndjekur çështjen. Për realizimin e mbrojtjes gjyqësore, struktura përgjegjëse kërkon informacion pranë drejtorive të tjera, të cilat kanë marrë pjesë në hartimin e aktit ose në procedurën e kundërshtuar. Në rast se vlerësohet e rëndësishme, struktura përgjegjëse për ndjekjen e çështjeve gjyqësore, i kërkon drejtorisë teknike caktimin e një nëpunësi për të përfaqësuar çështjen në gjykatë së bashku me nëpunësin e strukturës përgjegjëse.

3. Për vendimet e formës së prerë, struktura përgjegjëse për ndjekjen e proceseve gjyqësore, pas marrjes së kërkesës për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, të protokolluar pranë institucionit, bën verifikimin e dokumentacionit shoqërues. Në rast se kërkesa për ekzekutimin e vendimit, e paraqitur vullnetarisht ose nëpërmjet shërbimit përmbarrimor nuk shoqërohet nga dokumentacioni i nevojshëm, struktura përgjegjëse për ndjekjen e proceseve gjyqësore i kërkon kreditorit/shërbimit përmbarrimor plotësimin e dokumentacionit.



Me paraqitjen e kërkesës për ekzekutim nga shërbimi përmbarimor, struktura përgjegjëse për ndjekjen e çështjeve gjyqësore paraqet pranë Gjykatës së Lartë, kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, duke njoftuar edhe përmbaruesin gjyqësor.

4. Në çdo rast, vendimi i formës së prerë dhe dokumentacioni shoqëruar i përcillet strukturës përgjegjëse për financën.

5. Në rastin kur struktura përgjegjëse për financat do të bëjë ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, nga ana e kreditorit/përmbaruesit gjyqësor duhet të jetë depozituar:

a) Dokumenti që vërteton njoftimin e njësise shpenzuese debitore për ekzekutimin vullnetar dhe/ose të detyruar të detyrimit dhe marrjen dijeni nga ana e tij;

b) Vendimi gjyqësor, i cili, në kuptim të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile, konsiderohet si titull ekzekutiv, sipas rastit, origjinal apo i noterizuar ose i vërtetuar “njësia me origjinalin”.

6. Kërkesa për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për çështje të pronës publike dhe dëmshpërblimet për ish-të përndjekurit politik, pasi plotësohet dokumentacioni si më lart, u përcillet edhe strukturave përgjegjëse.

7. Në rast se, kërkesa për ekzekutim lidhet me një vendim gjyqësor, që parashikon detyrimin e institucionit të rikthejë në punë një ish-punonjës, pjesë të shërbimit civil, dokumentacioni i plotë i përcillet edhe strukturës përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore. Kjo e fundit, me marrjen dijeni të kërkesës, njofton Sekretarin e Përgjithshëm dhe merr masat për caktimin e mbledhjes së Komisionit të Posaçëm për Shqyrtimin e Vendimeve Gjyqësore të Formës së Prerë, me qëllim shqyrtimin e kërkesës për ekzekutim.

8. Struktura përgjegjëse për financat, pas marrjes së dokumentacionit, verifikimit të fondeve buxhetore dhe radhës së pagesës, sipas databazës të përcjellë nga struktura përgjegjëse për ndjekjen e çështjeve gjyqësore, i paraqet nëpunësit autorizues propozim për miratimin e kërkesës për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Praktika, në çdo rast shoqërohet me aktin financiar.

9. Në rastet kur, struktura përgjegjëse për financat, me fondet buxhetore, që ka në dispozicion, nuk është në gjendje të shlyejë detyrimin e plotë sipas vendimit gjyqësor, ajo bën me dije nëpunësin autorizues. Në informacionin që paraqet, struktura përgjegjëse për financat i parashtron nëpunësit autorizues mundësitë për ekzekutim, për sa i takon vlerës dhe periodicitetit të pagesave.

Me miratimin e nëpunësit autorizues, struktura përgjegjëse për ndjekjen e proceseve gjyqësore, në bazë të nenit 517 të Kodit të Procedurës Civile, i drejtohet gjykatës me kërkesë, për shlyerjen pjesore të detyrimit me fondet e vitit/viteve në vijim, duke bërë edhe njoftimin përkatës, pranë përmbaruesit gjyqësor.

KREU III TË TJERA

1. Aneksi 1, “Gjurma e auditimit për procedurat e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore”, është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2. Ngarkohen strukturat e përcaktuara në këtë udhëzim për zbatimin e tij.

3. Udhëzimi nr. 15, datë 18.7.2012, “Mbi procedurat që ndiqen për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, me objekt: rikthim në vendin e punës, kthim page, dëmshpërblim për largim nga puna dhe kthim shume”, i ministrit të Financave; udhëzimi nr. 1283, datë 16.2.2015, “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në llogari të thesarit”, i ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe çdo akt tjetër, që bie në kundërshtim me këtë udhëzim, shfuqizohen.


Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


MINISTRI I FINANCAVE DHE
EKONOMISË
Arben Ahmetaj




Aneksi 1. Procedura e ndjekjes së çështjeve gjyqësore dhe ekzekutimi i VGJFP

Faqe 1 nga 4










Procedura e ndjekjes së çështjeve gjyqësore dhe ekzekutimi i VGJFP

Faqe 4 nga 4


Simbole/Shkurtime



Fillimi ose mbarimi i një aktiviteti



Aktivitetet e kontrollit



Vendimi



Dokumenti i përfutur



Lidhja me faqen tjetër



Komente

NJQP - Njësi të Qeverisjes së Përgjithshme

NA - Nënpunësi Autorizues

NPA - Nënpunësi i Parë Autorizues

SPF- Struktura Përgjegjëse për Financat

SPBNJ- Struktura Përgjegjëse për Burimet Njerëzore

SPNPGJ- Struktura Përgjegjëse për Ndjekjen e Proceseve Gjyqësore

VGJFP – Vendime Gjyqësore të Formës së Prerë

VGJ – Vendime Gjyqësore

PGJ – Përmbaruesi Gjyqësorë

MFE – Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Phase

**URDHËR****Nr. 300, datë 11.4.2018****PËR MIRATIMIN E FORMULARIT DHE
KËRKESAT E RAPORTIT MBI SIGURINË
E PRODUKTIT KOZMETIK**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 10, pika 1, të ligjit nr. 26/2017, “Për produktet kozmetike”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e formularit dhe kërkesat e raportit mbi sigurinë e produktit kozmetik, sipas shtojcës nr. 1 dhe shtojcës nr. 2 bashkëlidhur këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE

Ogerta Manastirliu

SHTOJCA 1**PJESA A****INFORMACIONI PËR SIGURINË E
PRODUKTEVE KOZMETIKE**

1. Përbërja sasiore dhe cilësore e produktit kozmetik

Përbërja cilësore dhe sasiore e produktit kozmetik, duke përfshirë edhe identitetin kimik të substancave (duke përfshirë kur është e mundur emrin e kimikatit, INCI, CAS, EINECS/ELINCS) dhe funksionin e tyre të synuar. Në rastin e parfumit dhe përbërjeve aromatike, përshkrimin e emrit dhe kodin e përbërjes, si dhe identitetin e furnitorit.

2. Karakteristikat fizike/kimike dhe qëndrueshmëria e produktit kozmetik

Karakteristikat fizike dhe kimike të substancave ose përzierjeve, si dhe të produkteve kozmetike.

Qëndrueshmëria e produktit kozmetik në kushtet e magazinimit të parashikuara në mënyrë të arsyeshme.

3. Cilësia mikrobiologjike

Specifikimet mikrobiologjike të substancës ose të përzierjes dhe produktit kozmetik. Duhet t'u kushtohet vëmendje e veçantë produkteve kozmetike të përdorura rreth syve, në membranën e mukozës në përgjithësi, në lëkurën e dëmtuar, te

fëmijët nën moshën tre vjeç, te të moshuarit dhe te personat me imunitet të dobët.

Rezultatet e testit të sfidës së konservimit.

4. Papastërtitë, gjurmët, informacioni për materialin e paketimit

Pastërtia e substancave dhe përzierjet

Në rastin e gjurmëve të substancave të ndaluara, dëshmi për pashmangshmërinë e tyre teknike.

Karakteristikat përkatëse të materialeve të paketimit, në veçanti pastërtitë dhe qëndrueshmëria.

5. Përdorimi normal dhe i parashikuar në mënyrë të arsyeshme

Përdorimi normal i produktit dhe i parashikuar në mënyrë të arsyeshme. Arsyetimi justifikohet, veçanërisht, sipas paralajmërimeve dhe shpjegimeve të tjera në etiketimin e produktit.

6. Ekspozimi ndaj produktit kozmetik

Të dhënat për ekspozimin ndaj produktit kozmetik, duke marrë parasysh gjetjet sipas seksionit 5, në lidhje me:

1. Vendin/vendet e aplikimit;

2. Sipërfaqen e zonës/të zonave të aplikimit;

3. Sasinë e produktit të aplikuar;

4. Kohëzgjatjen dhe frekuencën e përdorimit;

5. Rruga/rrugët normale të ekspozimit të parashikuara në mënyrë të arsyeshme;

6. Popullsia e synuar (ose e ekspozuar). Do të merret në konsideratë edhe ekspozimi i mundshëm i një popullate të caktuar.

Llogaritja e ekspozimit merr në konsideratë efektet toksikologjike që duhen marrë parasysh (p.sh., ekspozimi mund të ketë nevojë të llogaritet për njësi të pjesëve të lëkurës apo për njësi të peshës trupore). Duhet të merret në konsideratë edhe mundësia e ekspozimit dytësor nga rrugë të tjera ndryshe nga ato që rezultojnë nga aplikimi i drejtpërdrejtë (p.sh., frymëthithja e paqëllimshme e spërkatësve, gëlltitja e paqëllimshme e produkteve të buzëve etj.).

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet çdo ndikimi të mundshëm ndaj ekspozimit për shkak të madhësive të imëta.

7. Ekspozimi ndaj substancave

Të dhënat për ekspozimin ndaj substancave të përfshira në produkte kozmetike për pikat përfundimtare toksikologjike përkatëse, duke marrë në konsideratë informacionin sipas nenit 8, të ligjit nr. 26/2017, datë 16.3.2017, “Për produktet kozmetike”.



8. Profili toksikologjik i substancave

Profili toksikologjik i substancës në produktet kozmetike për të gjitha pikat përfundimtare toksikologjike përkatëse. Fokus i veçantë i kushtohet vlerësimit lokal të toksicitetit (acarimit të lëkurës dhe syve), ndjeshmërisë së lëkurës dhe në rastin e toksicitetit të nxitur me anë të përthithjes së rrezeve UV.

Do të merren në konsideratë të gjitha rrugët e rëndësishme toksikologjike të përthithjes, si dhe efektet sistematike dhe marzhi i sigurisë (MiS) do të llogaritet bazuar në një nivel efektesh negative të pambikëqyrrur (NOAEL). Mungesa e këtyre pikëpamjeve duhet të justifikohet siç duhet.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet çdo ndikimi të mundshëm ndaj profilit toksikologjik për shkak të:

- Madhësisë së grimcave, duke përfshirë nanomaterialet;
- Papastërtive të substancave dhe të lëndëve të para të përdorura; dhe
- Ndërveprimet të substancave.

Çdo lexim gjithëpërfshirës duhet të argumentohet dhe të justifikohet siç duhet.

Burimi i informacionit duhet të identifikohet qartë.

9. Efektet e padëshiruara dhe efektet e padëshiruara të rënda

Të gjitha të dhënat në dispozicion për efektet e padëshiruara dhe efektet e padëshiruara të rënda të produkteve kozmetike ose, sipas rastit, të produkteve të tjera kozmetike. Këtu përfshihen të dhëna statistikore.

10. Informacioni për produktin kozmetik

Informacione të tjera të rëndësishme, p.sh., studime ekzistuese nga vullnetarë apo gjetje të konfirmuara dhe të provuara siç duhet për vlerësimin e rrezikut, të kryera në fusha të tjera të lidhura.

PJESA B

VLERËSIMI I SIGURISË SË PRODUKTTT KOZMETIK

1. Përfundimet e vlerësimit

Deklarata për sigurinë e produktit kozmetik në lidhje me nenin 4, të ligjit nr. 26/2017, datë 16.3.2017, “Për produktet kozmetike”.

2. Paralajmërimet e shënuara në etiketë dhe udhëzimet e përdorimit

Deklarata në lidhje me nevojën për të shënuar në etiketë çdo paralajmërim të veçantë dhe udhëzimet e përdorimit në përputhje me nenin 16, të ligjit nr. 26/2017, datë 16.3.2017, “Për produktet kozmetike”.

3. Arsytimi

Shpjegimi i arsytimit shkencor që çon në përfundimin e vlerësimit, të përcaktuar sipas seksionit 1 dhe deklaratës së përcaktuar sipas seksionit 2. Ky shpjegim bazohet te përshkrimet e përcaktuara në pjesën A. Kur është nevoja, duhet të vlerësohen dhe të diskutohen marzhet e sigurisë.

Ndër të tjera, do të bëhet një vlerësim i veçantë për produktet kozmetike të destinuara për përdorim te fëmijët nën moshën tre vjeç dhe për produktet kozmetike të destinuara ekskluzivisht për përdorim të jashtëm të higjienës intime.

Do të vlerësohen ndërveprime të mundshme të substancave të produktet kozmetike.

Marrja ose jo në konsideratë e profileve të ndryshme toksikologjike duhet të justifikohet siç duhet.

Ndikimet e qëndrueshmërisë për sigurinë e produktit kozmetik do të konsiderohen siç duhet.

4. Kredencialet e vlerësuesit dhe miratimin e pjesës B

Emri dhe adresa e vlerësuesit të sigurisë.

Prova kualifikimi të vlerësuesit të sigurisë.

Data dhe nënshkrimi i vlerësuesit të sigurisë.

SHTOJCA 2

RAPORTI I TË DHËNAVE TË SIGURISË
(SAFETY DATA SHEET) MSDS

Seksioni 1. Identifikimi i substancës/i përzierjeve dhe i kompanisë përgjegjëse
1.1 Identifikimi i produktit
1.2 Përdorimet kryesore të identifikuara të substancës ose të përzierësve dhe këshillat për mospërdorim
1.3 Detaje të ofruesit të raportit të të dhënave të sigurisë
1.4 Numrat e telefonit të emergjencës
Seksioni 2. Të dhëna mbi rrezikshmërinë (hazards)



2.1 Klasifikimi i substancës ose i përzierësve
2.2 Elementet e etiketimit
2.3 Rreziqe të tjera
Seksioni 3. Përbërja/informacioni mbi përbërësit
3.1 Substancat
3.2 Përbërësit
Seksioni 4. Masat e ndihmës së shpejtë
4.1 Përshkrimi i masave të ndihmës së shpejtë
4.2 Simptomat dhe efektet më të rëndësishme akute ose me veprim të mëvonshëm
4.3 Identifikimi i nevojës së trajtimit mjekësor të menjëhershëm ose i trajtimit të specializuar të nevojshëm
Seksioni 5. Masat kundërzjarrit
5.1 Mjetet e shuarjes së zjarrit
5.2 Rreziqe të veçanta që lindin nga substanca ose përzierësit
5.3 Këshilla për zjarrfikësit
Seksioni 6. Masat në rastet e shpërndarjes aksidentale
6.1 Kujdesi personal, mjetet e mbrojtjes, si dhe procedurat e emergjencës
6.2 Masat mbrojtëse për ndikimin në mjedis
6.3 Mënyrat dhe materialet për kufizimin e përhapjes, si dhe për pastrimin
6.4 Referenca në seksionet e tjera
Seksioni 7. Administrimi dhe magazinimi
7.1 Masat mbrojtëse për administrim të sigurt
7.2 Kushtet për magazinim të sigurt përfshirë edhe rastet e veçanta.
7.3 Qëllimi/et e specifikuar të përdorimit të fundit
Seksioni 8. Kontrollat e ekspozimit/mbrojtja personale
8.1 Parametrat e kontrollit
8.2 Parametrat e ekspozimit
Seksioni 9. Vetitë kimike dhe fizike
9.1 Informacion mbi vetitë bazë fizike dhe kimike
9.2. Informacione të tjera
Seksioni 10. Stabiliteti dhe reaktiviteti
10.1 Reaktiviteti
10.2 Stabiliteti kimik
10.3 Mundësia e reaksioneve të rrezikshme
10.4 Rastet që duhen shmangur
10.5 Materialet e papajtueshme
10.6 Dekompozimi i produkteve të rrezikshme
Seksioni 11. Informacioni toksikologjik
11.1. Informacion mbi efektet toksikologjike
Seksioni 12. Informacioni ekologjik
12.1 Helmueshmëria
12.2 Qëndrueshmëria dhe degradueshmëria
12.3 Potenciali bioakumulativ
12.4 Lëvizshmëria në tokë
12.5 Rezultatet e vlerësimit të PBT-së dhe vPvB-së
12.6 Efekte të tjera të pafavorshme
Seksioni 13. Të dhëna mbi trajtimin e mbetjeve
13.1 Metodatat e trajtimit të mbetjeve
Seksioni 14. Informacion mbi transportin
14.1 Numri sipas OKB-së
14.2 Emri i saktë i transportit sipas OKB-së
14.3 Shkalla e rrezikshmërisë së transportit
14.4 Grupi i paketimit
14.5 Rreziqe mjedisore
14.6 Masa të veçanta për përdoruesit
14.7 Transporti i papaketuar, <i>bulk</i> , sipas shtojcës II të Konventës Marpol, si dhe të kodit IBC



Seksioni 15. Informacion mbi legjislacionin
15.1 Legjislacion mbi sigurinë, shëndetin, mjedisin, si dhe legjislacioni specifik për substancat dhe përzierësit
15.2 Vlerësimi mbi sigurinë kimike
Seksioni 16. Informacion shtesë

VENDIM**Nr. 22, datë 30.3.2018****PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME RROGOZHINË**

Në zbatim të nenit 14, pika 1/“a”, të nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, si dhe rregullores së licencimit, miratuar me vendim të KKRR-së nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar dhe, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Rrogozhinë sh.a., për licencim për efekt të përfundimit të afatit, Komisioni Kombëtar Rregullator

konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Rrogozhinë është licencuar për herë të fundit nga Komisioni Kombëtar Rregullator, me vendimin nr. 35, datë 11.12.2012, “Për rinovim licence sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Rrogozhinë”, me vlefshmëri 4 vjet.

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Rrogozhinë ka aplikuar për licencim me anë të shkresës nr. 130 prot., datë 28.8.2017, për efekt të përfundimit të afatit.

- Në dosjen e aplikimit mungonte dokumenti i aktmiratimit higjieno-sanitar, ndërkohë që ishte sjellë vetëm raport-analiza e burimeve nga Drejtoria e Shëndetit Publik. Dosja u plotësua me shkresën nr. 35 prot., datë 1.3.2018.

- Këshilli Bashkiak Rrogozhinë, me vendimin nr. 41, datë 20.6.2017, ka vendosur zmadhimin e kapitalit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Rrogozhinë sh.a., si pasojë e shtimit të kapitalit të njërive administrative Lekaj e Kryevindh, që më parë zotëroheshin nga Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë, por

shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Rrogozhinë sh.a. ende nuk i ka reflektuar këto ndryshime në QKB.

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Rrogozhinë, faktikisht e kryen shërbimin në dy njësitë administrative Lekaj dhe Kryevindh.

- Aplikimi i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Rrogozhinë sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara në “Rregulloren e licencimit për përfundimin e afatit të licencimit”, konkretisht:

- Format i aplikimit është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- Për dokumentin “Ekstrakti historik”, i Regjistrat Tregtar, në të cilin ende nuk janë reflektuar ndryshimet sipas riorganizimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Rrogozhinë sh.a., bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Rrogozhinë detyrohet të paraqesë pranë ERRU-së ekstraktin e QKB-së të përditësuar menjëherë pas përfundimit të procesit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit Ujësjiellës-Kanalizime Rrogozhinë sh.a., me:

Drejtues ligjor dhe drejtues teknik: Bujar Meraj

2. Operatori sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Rrogozhinë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Rrogozhinë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Ndriçim Shani**



VENDIM

Nr. 23, datë 30.3.2018

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 10, DATË 21.3.2017, “PËR
LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-
KANALIZIME VLORE”**

Në zbatim të nenit 14, pika 1/“a”, të nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, si dhe rregullores së licencimit, miratuar me vendim të KKRR-së nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar dhe, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë sh.a., për licencim për efekt të ndryshimit të zonës së shërbimit, Komisioni Kombëtar Rregullator

konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë është licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 10, datë 21.3.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë.

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë ka aplikuar për licencim me anë të shkresës nr. 268 prot., datë 15.2.2018, për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të zonës së shërbimit.

- Aplikimi i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë sh.a. plotëson të gjitha kërkesat e parashikuara në “Rregulloren e Licencimit mbi ndryshimin e zonës së shërbimit”, konkretisht:

- Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë sh.a. ka rritur kapitalin e shoqërisë, duke zmadhuar zonën e shërbimit nga bashkimi me përthithje i shoqërisë Ujësjiellës Novoselë sh.a. dhe shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Orikum sh.a.;

- Format i aplikimit është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Pika 3 e vendimit nr. 10, datë 21.3.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë” ndryshohet si më poshtë:

“Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Vlorë”.

2. Vendimi i KKRR-së nr. 20, datë 20.10.2014, “Për rinovim licence sh.a. Ujësjiellës Orikum”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM

Nr. 24, datë 30. 3.2018

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 41, DATË 6.10.2017, “PËR
LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS
GRAMSH”**

Në zbatim të nenit 14, pika 1/“a”, të nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, si dhe rregullores së licencimit, miratuar me vendim të KKRR-së nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar dhe, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjiellës Gramsh sh.a. për licencim për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik, Komisioni Kombëtar Rregullator

konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjiellës Gramsh është licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 41, datë 6.10.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës Gramsh”.

- Shoqëria Ujësjiellës Gramsh ka aplikuar me anë të shkresës nr. 217 prot., datë 1.3.2018, për licencim për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik.

- Aplikimi i shoqërisë Ujësjiellës Gramsh sh.a. plotëson të gjitha kërkesat e parashikuara në



“Rregulloren e licencimit mbi ndryshimin e drejtuesit teknik”, konkretisht:

- Dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- Drejtuesi teknik plotëson kriteret e parashikuara në rregulloren e licencimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

Në pikën 1, të vendimit nr. 41, datë 6.10.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës Gramsh”, bëhen këto ndryshime:

“Drejtues teknik: Rudin Dyrmyshi”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 25, datë 30.3.2018

**PËR MOSMARRJEN NË SHQYRTIM TË
APLIKIMIT PËR MIRATIMIN E
TARIFAVE TË FURNIZIMIT ME UJË
DHE LARGIMIT TË UJËRAVE TË
NDOTURA PËR SHOQËRINË
UJËSJIJELLËS-KANALIZIME SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit e ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit e ujërave të ndotura” dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar

Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura”, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Teknike-Ekonomike mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër sh.a., për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, Komisioni Kombëtar Rregullator

konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër është licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator, me vendimin nr. 55, datë 29.12.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër”.

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër, me anë të shkresës nr. 739 prot., datë 30.6.2017, ka aplikuar për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura.

- Dosja e aplikimit u paraqit me mungesa në dokumentacion, si “Vendimi i Këshillit Bashkiak si opinion për tarifat e reja të propozuara”, “Raporti i ekspertit kontabël”, “Procesverbali i seancës dëgjimore me publikun” dhe “Modeli i aplikimit” dhe u plotësua pjesërisht vetëm pas insistimit të Entit Rregullator të Ujit.

- Edhe pas kërkesave të Entit Rregullator të Ujit, “Vendimi i Këshillit Bashkiak si opinion për tarifat e reja të propozuara”, ende nuk është paraqitur.

- Në mbledhjen e datës 30.3.2018, Komisioni Kombëtar Rregullator analizoi dhe një herë situatën e aplikimeve për ndryshimin e tarifave dhe gjykoj se ka kaluar një periudhë e gjatë bashkëpunimi ku shoqëria UK Shkodër ende nuk është treguar korrekte me plotësimin e dokumentacionit të kërkuar me qëllim vijimin e procedurës nga ERRU-ja.

Për sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të mos marrë në shqyrtim aplikimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër sh.a. për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër detyrohet të aplikojë për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura me dokumentacionin dhe të



dhënat e plota, brenda datës 30.6.2018, pasi në të kundërt do të zbatohen sanksionet që parashikon ligji në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 26, datë 30.3.2018

MBI MOSMARRJEN NË SHQYRTIM TË
APLIKIMIT PËR MIRATIMIN E
TARIFAVE TË FURNIZIMIT ME UJË
DHE LARGIMIT TË UJËRAVE TË
NDOTURA PËR SHOQËRINË
UJËSJELLËS-KANALIZIME KRUJË

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura” dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, pasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Krujë sh.a., për miratimin e tarifave të

shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, Komisioni Kombëtar Rregullator

konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Krujë është licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 18, datë 5.5.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Krujë”.

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Krujë me anë të shkresës nr. 413 prot., datë 26.4.2017 ka aplikuar për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura.

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Krujë sh.a. nuk ka shlyer detyrimin e pagesës rregullatore që buron nga kontrata, datë 1.6.2007, mes saj dhe Entit Rregullator të Ujit.

- Dosja e aplikimit u paraqit me mungesa në dokumentacion si “Modeli i aplikimit” dhe “Procesverbali i seancës dëgjimore” dhe u plotësua pjesërisht vetëm pas insistimit të Entit Rregullator të Ujit.

- Edhe pas kërkesave të Entit Rregullator të Ujit, modeli i aplikimit për ndryshimin e tarifave rezultoi të jetë i papërfunduar dhe me të dhëna të pasakta.

Për sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të mos marrë në shqyrtim aplikimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Krujë sh.a. për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Krujë detyrohet të aplikojë për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura me dokumentacionin dhe të dhënat e plota, brenda datës 30.6.2018, pasi në të kundërt do të zbatohen sanksionet që parashikon ligji në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 175 lekë